



Pranuar / Dorezuar Primjeño/Prodato Received/Delivered	22-08-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shloq Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKUPIMSHKX	5765	/2023	113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.977/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.977/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Pejës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën me numër A.nr.977/2023 të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesi
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Pejës sipas Kontratës së Punës me numër 01-112-187938 të datës 04.01.2012 në pozitën e punës "Shpërndarës poste", më datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5230/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër reference 01-400/01-0054175/23 të datës 13.06.2023 të Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për harmonizimin e koeficientit të pagës, nga koeficienti aktual tre pikë gjashtëdhjetë e nëntë (3.69) në pesë (5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës, ndërsa me datë 25.07.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5230/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë me numër Nr.01-400/01-0054175/23 e datës 13.06.2023; Kontratën e Punës me numër 01-112-187938 të datës 04.01.2012; Kopje e letërnjoftimit për G.K; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 25.07.2023; Kërkesë për korigjim/harmonizim të koeficientit të pagave me numër Nr.01-016101-52631 e datës 08.06.2023; Diplomë me numër Nr.611-454 e datës 29.05.86; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës i datës 27.09.2012; Tabelën në formën Exel lidhur me propozimin e koeficientëve; Listë e pagave për muajin shkurt 2023; Vendim me numër Nr.01-112/01-0094302/2022 të datës 23.08.2022.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi në bazë të Vendimit me numër Nr.01-112/01-0094302/2022 të datës 23.08.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës, i është njohur statusi i nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; " ...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se " Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës" rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës me numër 01-112-187938 të datës 04.01.2012, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita "Shpërndarës Poste", hynë në kategorinë e nëpunësve "Administrativo-Teknik dhe Mbështetës".

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se nëpunësi administrativ-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj pas konstatimi së ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit vlerëson së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës të nëpunësve "Administrativo-Teknik dhe Mbështetës", andaj mbi këtë bazë Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën parashtruar nga ankuesi

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër protokollit 523 të datës 14.07.2023 dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk ka shfrytëzuar

mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.977/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;